



Partia Demokratike e Shqipërisë

Nr. 52 Prot.

Elbasan, më 07/04/2021

KALLËZIM PENAL

Kallëzues: Partia Demokratike e Shqipërisë, përfaqësuar nga Z. Gazment Bardhi, Sekretar i Përgjithshëm

Objekti: Kallëzim penal ndaj disa shtetasve për veprat penale “Grup i Strukturuar Kriminal” parashikuar nga neni 333/a, Neni 325 “Pengimi i subjekteve zgjedhore”, Neni 328 “Korrupsioni aktiv në zgjedhje”, Neni 331/a “Marrja ose përdormi i paligjshëm i dokumenteve të identifikimit”, Neni 332/a “Shpërdorimi i autoritetit policor” dhe “Grup i strukturuar kriminal” të Kodit Penal.

Baza Ligjore: Nenet 75/a, 280, 283 e vijues të K.Pr.Penale, neni 328, 328/a, 328/b, 329 dhe 331/a të Kodit Penal, nenet 8, 9, 10 e vijues të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Drejtuar: PROKURORISË SË POSAÇME KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT – SPAK

TIRANË

I nderuar Z. Drejtues i Prokurorisë,

Më datë 25 Prill 2021 në Shqipëri do të zhvillohen zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë. Partitë politike kanë caktuar kandidatët dhe janë duke zhvilluar fushatën zgjedhore. Në qarkun e Elbasanit, nga ana e kandidatëve të Partisë Socialiste është ngritur një infrastrukturë kriminale që cënon standardet e zgjedhjeve. Konkretisht, nga informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga strukturat e Partisë Demokratike është vërejtur një rritje e aktivitetit kriminal në Qarkun e Elbasanit, i cili konsiston kryesisht në kërcënimin e strukturave të